



VENDIM

Nr. 177, datë 8.3.2017

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 165, DATË 2.3.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR GRUPIMIN E NJËSIVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE, PËR
EFEKT PAGE, DHE CAKTIMIN E
KUFIJVE TË PAGAVE TË
FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË
EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E
TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË
NJËSIVE TË VETËQEVERISJES
VENDORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, shkronja “c”, 4, shkronja “d”, e 5, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të neneve 46, 54, 65, 71 e 77, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 165, datë 2.3.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) nivelet e pagave, për funksionarët e zgjedhur të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive të njësive të vetëqeverisjes vendore, të përmendur nga shkronja “b” deri në shkronjën “e”, të pikës 1, të vendimit, ndryshojnë si vijon:

“b) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me 200 001– 400 000 dhe me mbi 400 000 banorë:

- Kryetari 130 000 – 162 750 lekë;
- Nënkryetari 100 000 – 138 000 lekë.

c) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me 100 001 – 200 000 banorë:

- Kryetari 110 000 – 150 000 lekë;
- Nënkryetari 70 000 – 125 725 lekë.

ç) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me 50 001–100 000 banorë:

- Kryetari 70 000 – 125 725 lekë;
- Nënkryetari 60 000 – 101 650 lekë.

d) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me 20 001– 50 000 banorë:

- Kryetari 60 000 – 101 650 lekë;
- Nënkryetari 45 000 – 86 100 lekë.

dh) Për njësitë e vetëqeverisjes vendore me deri në 20 000 banorë:

- Kryetari 45 000 – 86 100 lekë;
- Nënkryetari 28 300 – 75 500 lekë.

e) Për Këshillin e Qarkut:

- Kryetari 87 000 – 150 000 lekë;
- Nënkryetari 57 600 – 101 650 lekë.”.

b) Lidhja nr. 1, “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë në Bashkinë e Tiranës”, që përmendet në pikën 2, të vendimit, zëvendësohet me lidhjen nr. 1, me të njëjtin emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) Lidhjet nr. 2, 3, 4, 5 e 6, “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë e tjera”, që përmenden në pikën 3, të vendimit, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

ç) Lidhja nr. 7, “Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë në këshillin e qarkut”, që përmendet në pikën 4, të vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

d) Në paragrafin e parë të pikës 9, mbas fjalëve “Shkenca kompjuterike”, shtohen “Teknologji informacioni”, “Informatikë ekonomike” dhe “Inxhinieri matematike informatike”.

dh) Në fund të pikës 9, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Miratimi i këtyre shtesave bëhet rast pas rasti nga këshillat përkatës, pas verifikimit nga njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore, për llojin e diplomës dhe për përshkrimin e pozicionit të punës.”.

e) Lidhja nr. 8, “Kufijtë e pagave për punonjësit e policisë bashkiake, pranë bashkive”, që përmendet në pikën 12, të këtij vendimi, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

ë) Në pikën 13, bëhen këto ndryshime:

i) Fjalët “Lidhja nr. 7”, zëvendësohen me “Lidhja nr. 10”;

ii) Lidhja “Struktura dhe kufijtë e pagave për administratorët e njësive administrative”, zëvendësohet me lidhjen nr. 10, me të njëjtin emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

f) Kufiri maksimal i pagës, i përcaktuar në pikën 18, të vendimit, nga 36 000 lekë që është aktualisht, bëhet 39 000 lekë.

g) Kufijtë e pagave bazë të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore



të përcaktuar në pikën 19, të vendimit, ndryshojnë dhe bëhen nga 30 000 në 39 000 lekë në muaj.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga të ardhurat e veta të organeve/njësive të vetëqeverisjes vendore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LIDHJA NR. 1
NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKINË E TIRANËS

PAGA MUJORE (LEKË)						
KLASA	KATEGORIA	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	PAGA INDIVIDUALE			SHTESA PËR POZICION
	1		2	3	4	5
			Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	Sekretar i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 69.000 deri 129800
II	II-a	Drejtor i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 66.000 deri 118.100
	II-b	Drejtor drejtorie	1	2%	0	Nga 58.000 deri 100.000
III	III-a	Përgjegjës sektori	1	2%	0	Nga 32.000 deri 80.800
	III-a/1	Përgjegjës sektori	1	2%	0	Nga 29.000 deri 70.500
	III-b	Specialist Inspektor	1 ose 2	2%	0	Nga 27.000 deri 61.000
IV	IV-a	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 25.000 deri 49.000
	IV-b	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 23.000 deri 38.000

LIDHJA NR. 2
NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKITË ME 200.001–400.000 BANORË DHE ME MBI 400.000 BANORË

PAGA MUJORE (LEKË)						
KLASA	KATEGORIA	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	PAGA INDIVIDUALE			SHTESA PËR POZICION
	1		2	3	4	5
			Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	Sekretar i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 69.000 deri 115.300
II	II-a	Drejtor i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 66.000 deri 98.100
	II-b	Drejtor drejtorie	1	2%	0	Nga 58.000 deri 79.600
III	III-a	Përgjegjës sektori	1	2%	0	Nga 32.000 deri 69.800



	III-a/1	Përgjegjës sektori	1	2%	0	Nga 29.000 deri 64.200
	III-b	Specialist Inspektor	1 ose 2	2%	0	Nga 27.000 deri 61.000
IV	IV-a	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 25.000 deri 49.000
	IV-b	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 23.000 deri 38.000

LIDHJA NR. 3

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKITË
ME 100.001–200.000 BANORË

PAGA MUJORE (LEKË)						
KLASA	KATEGORIA	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	PAGA INDIVIDUALE			SHTESA PËR POZICION
	<i>1</i>		<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
			Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	Sekretar i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 58.000 deri 98.100
II	II-a	Drejtor i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 32.000 deri 79.600
	II-b	Drejtor drejtorie	1	2%	0	Nga 29.000 deri 69.800
III	III-a	Përgjegjës sektori Kryeinspektor	1	2%	0	Nga 28.000 deri 68.000
	III-a/1	Përgjegjës sektori	1	2%	0	Nga 27.000 deri 64.200
	III-b	Specialist Inspektor	1 ose 2	2%	0	Nga 27.000 deri 61.000
IV	IV-a	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 25.000 deri 49.000
	IV-b	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 23.000 deri 38.000

LIDHJA NR. 4

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKITË ME 50.001-100.000 BANORË

PAGA MUJORE (LEKË)						
KLASA	KATEGORIA	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	PAGA INDIVIDUALE			SHTESA PËR POZICION
	<i>1</i>		<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
			Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	Sekretar i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 32.000 deri 79.600
II	II-b	Drejtor drejtorie	1	2%	0	Nga 27.000 deri 64.200
III	III-a/1	Përgjegjës sektori Kryeinspektor	1	2%	0	Nga 27.000 deri 61.000



	III-b	Përgjegjës sektori Specialist Inspektor	1 ose 2	2%	0	Nga 25.000 deri 49.000
IV	IV-a	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 23.000 deri 38.000
	IV-b	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 21.500 deri 29.500

LIDHJA NR. 5

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKITË ME 20.001-50.000 BANORË

PAGA MUJORE (LEKË)						
KLASA	KATEGORIA	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	PAGA INDIVIDUALE			SHTESA PËR POZICION
	1		2	3	4	5
			Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	Sekretar i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 29.000 deri 69.800
II	II-b	Drejtor drejtorie	1	2%	0	Nga 27.000 deri 61.000
III	III-a/1	Përgjegjës sektori Kryeinspektor	1	2%	0	Nga 25.000 deri 49.000
	III-b	Përgjegjës sektori	1 ose 2	2%	0	Nga 25.000 deri 42.800
IV	IV-a	Specialist Inspektor	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 23.000 deri 35.900
	IV-b	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 23.000 deri 29.500

LIDHJA NR. 6

NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKITË ME DERI NË 20.000 BANORË

PAGA MUJORE (LEKË)						
KLASA	KATEGORIA	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	PAGA INDIVIDUALE			SHTESA PËR POZICION
	1		2	3	4	5
			Paga e grupit	Shtesa për Vjetërsi	Shtesa për Kualifikim	Shtesa për Pozicion
I	I-b	Sekretar i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 27.000 deri 61.000
II	II-b	Drejtor drejtorie	1	2%	0	Nga 25.000 deri 49.000
III	III-a/1	Përgjegjës sektori	1	2%	0	Nga 25.000 deri 42.800
	III-b	Përgjegjës sektori	1 ose 2	2%	0	Nga 22.500 deri 35.900
IV	IV-a	Specialist Inspektor	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 22.000 deri 32.000
	IV-b	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 21.000 deri 26.750



LIDHJA NR. 7
NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË KËSHILLIN E QARKUT

PAGA MUJORE (LEKË)						
KLASA	KATEGORIA	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	PAGA INDIVIDUALE			SHTESA PËR POZICION
	1		2	3	4	5
			Paga e grupit	Shtesa për vjetërsi	Shtesa për kualifikim	Shtesa për pozicion
I	I-b	Sekretar i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 58.000 deri 98.100
II	II-b	Drejtor drejtorie	1	2%	0	Nga 32.000 deri 79.600
III	III-a/1	Përgjegjës sektori	1	2%	0	Nga 29.000 deri 69.800
	III-b	Përgjegjës sektori Specialist Inspektor	1 ose 2	2%	0	Nga 27.000 deri 61.000
IV	IV-a	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 25.000 deri 49.000
	IV-b	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 23.000 deri 38.000

LIDHJA NR. 8
STRUKTURA DHE KUFIJTË E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E POLICISË BASHKIAKE PRANË BASHKIVE

Emërtesa/pozicioni	Paga (lekë/muaj)	
	Nga	Deri
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	79000	97.300
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 200001 deri në 400000 banorë dhe me mbi 400.000 banorë	65.000	79.200
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 100001 deri në 200.000 banorë	63.000	77.000
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 50001 deri në 100.000 banorë	61.000	76.500
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 20001 deri në 50.000 banorë	51.000	61.000
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me deri në 20.000 banorë	49.500	57.300
Inspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	61000	76.500
Inspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 200001 deri në 400000 banorë dhe me mbi 400.000 banorë	49500	57.300
Inspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 100001 deri në 200.000 banorë	48.000	55.600
Inspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 50001 deri në 100.000 banorë	45.000	55.600
Inspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 20001 deri në 50.000 banorë	40.000	47.600
Inspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me deri në 20.000 banorë	38.000	46.000



Punonjës i Policisë Bashkiake të Tiranës	50000	58.850
Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore, me 200001 deri në 400000 banorë dhe me mbi 400.000 banorë	44000	51.300
Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore, me 100001 deri në 200.000 banorë	41500	49.300
Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore, 50001 deri në 100.000 banorë	40.000	47.600
Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore, me 20001 deri në 50.000 banorë	38000	46.000
Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me deri 20000 banorë	36.000	44.400

LIDHJA NR. 10

KUFIJTË E PAGAVE PËR ADMINISTRATORËT E NJËSIVE ADMINISTRATIVE

1.	Për njësitë administrative me 50.001 – 100.000 banorë; - Administratori 70.000 – 125.700 lekë
2.	Për njësitë administrative me 20.001 – 50.000 banorë; - Administratori 51.500 - 99.000 lekë
3.	Për njësitë administrative me 5.001 – 20.000 banorë; - Administratori 41.400 – 85.000 lekë
4.	Për njësitë administrative me më pak se 5.000 banorë; - Administratori 37.400 – 60.000 lekë